

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[09 Maj 2016]

Për: **“VËLLAZËRIA” sh.p.k**

J76418901I Adresa: KRUME ish Bashkia Krume-Has.

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur-Punë, rruge elektronike;**

1. Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Projekt Zbatimi per Efiçencen e Energjië e Ndertesës**

Ekzistuese 4-Kt, ne Bashkepronësi, ne qender te qytetit Krumë”;

Fondi Limit: **14,816,032.0 (Katermbëdhjetemilion e teteqind e gjashtëmbëdhjetemije e tridhjetë e dy) lekë, pa TVSH.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike **[29 Mars 2016]** [Buletini **Nr.12**] ne APP.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Burimi i Financimit: **Buxheti Shtetit** (bashkisë Has);

Bazuar ne Nenin 58/2te ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenit 69të VKM nr.914, date 29/12/2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **“ALKO-IMPEX General Construcion”sh.p.k** NIPT:**K91326028I**

Vlera**8,445,138**leke (tetëmilion e katërqind e dyzet e pesëmijë e njëqind e tridhjetë e tetë) leke pa tvsh

2. **“DENIS-05” sh.p.k** NIPT:**K51518029B**

Vlera **14,676,439**(katërmëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtëmijë e katërqind e tridhjetë e nëntë) leke pa tvsh.

3. **“NIKA” sh.p.k** NIPT:**J76705047U**

Vlera **9,795,974** (nentemilion shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) leke pa tvsh.

4. **“VËLLAZËRIA” sh.p.k** NIPT:**J76418901I**

Vlera **14,507,603** (katëmbëdhjetëmilin e pesëqind e shtatëmijë e gjashtëqind e tre) leke pa tvsh.

5. **“VLLAZNIMI” sh.p.k** NIPT: **J79602601O**

Vlera **14,816,013** (katëmbëdhjetëmilin e tetëqind e gjashtëmbëdhjetemijë e tremëdhjetë) leke pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **“ALKO-IMPEX General Construcion”SH.P.K**për arsyet e mëposhtme:

Drejtuesit teknik te shoqerise, sipas liçences nuk jane te deklaruar ne liste pagesat e kompanise.

Perkatesisht: Alaudin Behluli, Kujtim Gashi, Selver Beqiri, Agon Jakupi, Ajet Gashi, Hamdije Idrizi, Bekim Selmani, Sylejmon Latifi.

Per Punonjesit e tjere specialiste me deshmi te caktuar profesionale ka mosperptheje si me poshte:

- Për disa nga punonjësit e deklaruar në listë pagesat ka mosperptheje mes konfirmimit specialitetit në këto listëpagesa dhe faktit se për të njëjtët punonjës janë paraqitur dheshmi kualifikimi në profesione të tjera përkatësisht (Arben Deliu ne liste pagese figuron Shofer, e ne fakt eshte paraqitur deshmi kualifikimi ne profesion elektrikist; Defrim Bastari ne liste pagese figuron Shofer, e ne fakt eshte paraqitur deshmi kualifikimi ne profesion montator; Esat Isiu ne liste pagese figuron Punëtor krahu, e ne fakt eshte paraqitur deshmi kualifikimi ne profesion teknik

- ndertimi; Fatmir Shkreta figuron punëtor krahu sipas liste pageses, e ne fakt eshte paraqitur deshmi kualifikimi ne profesion Saldator; Gentian Bastari figuron i paguar Shofer sipas liste pageses , e ne fakt eshte paraqitur deshmi kualifikimi ne profesionin saldator; Kelmend Muçaj figuron i paguar Shofer sipas liste pageses, e ne fakt eshte paraqitur deshmi kualifikimi ne profesionin montator; Pellumb Tatushi figuron i paguar si Punëtor krahu sipas liste pageses, e ne fakt eshte paraqitur deshmi kualifikimi ne profesionin karpantier; Shpetim Ymerali figuron i paguar punëtor krahu sipas liste pageses , e ne fakt eshte paraqitur deshmi kualifikimi ne profesionin Suvator; Xhemal Deliu figuron i paguar Shofer sipas liste pageses, e ne fakt eshte paraqitur deshmi kualifikimi ne profesion Elektricitist; Zamir Sherifi figuron I paguar Punëtor krahu sipas liste pageses, e ne fakt eshte paraqitur deshmi kualifikimi ne profesionin karpantier;
- Deklarimi i Skelerve nuk eshte shoqeruar me certifikate standarteve(konform KTZ).
 - Kandidati (Ofertuesi) krahas dokumentacionit si deklarate per angazhimin e drejtuesit dhe stafit vetem ne kete objekt, nuk ka paraqitur (shoqeruar) i.Librezat e Punes perkatese.

Për sa më sipër, operatori ekonomik “ALKO-IMPEX General Construcion”sh.p.knuk ploteson kerkesat e percaktuara ne shtojcen 10, Kriteve te Veçanta te Kualifikimit, prandaj s’kualifikohet.

2. “DENIS-05” sh.p.k për arsyet e mëposhtme:

- I mungon “Formular vlerësimi sipas Shtojces 8” formulari i vlersimit bashkengjitur, ka të bëjë me kontratën e realizuar me pare; Nuk eshte bashkengjitur Grafiku i realizimit punime per objektin.
- **Vertetimi nga Credins Bank, mban daten 05.03.2016 (Kerkohej: Një vertetim të gjendjes financiare nga një banke qe verteton se shoqeria ka ne llogari rrjedhese nje shume jo me pak se 1,481,603(njemilion e katerqind e tetedhete e nje mije e gjashteqind e tre) leke, leshuar jo me heret se 10 dite nga dita e tenderit (data e hapjes se ofertave). Cka vertetimi i kerkuar nuk e permbush kriterin e afatit jo më herët se 10 ditë, (pjesë të kapaciteti ekonomik dhe financiar).**
- Skelerve i mungon certifikata sipas Standarteve Europiane me garanci teknike per qendrueshmerine e skelave dhe te punimeve te montimit dhe cmontimit te tyre, konform KTZ (Kushteve Teknike te Zbatimit) sipas manualeve te montimit dhe projektit; Vinci, me qera auto vinc, me kontrate te dates 03.09.2015, me nr.6810 Rep, 3544 Kol. Nuk ka cituar objektin as periudhen e qerese, i mungon siguracioni i mjetit (i ka mbaruar afati me date 15.12.2015), i mungon certifikata e kontrollit teknik (e vlefshme deri me date 14 korrik 2015); **Autokolle (Autovinc) me kontrate qeraje 2 cope me nr.6809 rep, 3543 kol, nuk ka objektin per te cilin jepet me qera. Dokumentacioni shoqerues i mjeteve ka mangesi (siguracioni ka perfunduar me date 30 nentor 2015, certifikata e kontrollit teknik i ka perfunduar me date 15 Nentor 2015, per mjetin me targa AA196BL); Per mjetin me targa TR2345T i mungojne (i kane perfunduar) siguracioni me date 23.12.2015, certifikata e kontrollit teknik me date 26 dhjetor 2015, kerkesa tëKapacitetit teknik të operatorit.**

Për sa më sipër, operatori ekonomik “Denis-05”shpk nuk ploteson kerkesat e percaktuara ne shtojcen 10, pika 2 Kriteve te Veçanta te Kualifikimit, te percaktuara ne dokumentat standarte te tenderit, prandaj skualifikohet.

3. Shoqeria “NIKA” sh.p.k nuk ploteson kerkesat e percaktuara ne shtojcen 10, pika 2 Kriteve te Veçanta te Kualifikimit, te percaktuara ne dokumentat standarte te tenderit.

Shoqeria “NIKA” sh.p.k nuk ka paraqitur Shtojcen 1 (Pershkrimi i Ofertes), shtojcen 5 (Deklarate mbi permbushjen e Specifikimeve Teknike) dhe shtojcen 7 (Deklarate mbi konfliktin e interesit) sipas formuleve te paraqitur ne DST, kerkese kjo e percaktuar ne shtojcen 10, pika 2 Kriteret e Veçanta te Kualifikimit, pika 1/a, b, c.

Raportet e auditit të ekspertit kontabel për **Bilancet e vitit 2012 dhe 2013 të shoqërisë "NIKA"** sh.p.k. janë përgatitur dhe firmosur nga eksperti kontabel Vehibe Shehu, kurse sipas QKR-se rezultoi se nga viti 2000 ka qenë e deklaruar eksperte kontabel të shoqërisë Eftali Qirjaqi. Pra, raportet e auditit të ekspertit kontabel nuk janë hartuar nga eksperti i deklaruar në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

Operatori ekonomik "NIKA" shpk nuk plotëson **Kapacitetin teknik, Përsëri përkatësitë teknike dhe profesionale**, "puna të ngjashme", në kundërshtim me kriteret dhe kushtet e kualifikimit.

Operatori ekonomik ka paraqitur kontratën me objekt: "Kompleks banimi 6 kat + 2 kat nësi shtesë + bodrum" data e përfundimit të kontratës sipas Formularit të Vlerësimit është në datë 10.04.2013, pra jashtë afatit të kërkuar për realizimin e objekteve.

Operatori ekonomik ka paraqitur kontratën me objekt: "Rikonstruksion i qendrës polivalente për shtesat dhe kujdesit shoqëror, Polican", kontratë e lidhur me investitorin Ministria e Punëve Sociale dhe shansëve të barabarta dhe për sipërmarrësin shoqëria "NIKA" shpk përfaqësuar nga Z. Pjetër Nika, për të cilin nuk është paraqitur asnjë dokument që të provojë se është përfaqësues ligjor i shoqërisë. Sipas QKR-se rezultoi si përfaqësues i shoqërisë vetëm Shpresa Nika, me cilësinë e ortakut të vetëm.

Operatori ekonomik "NIKA" shpk në deklaratën e caktimit të Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt nuk ka deklaruar se ai nuk është i angazhuar në kontratë të tjera, kërkesë dhe përcaktuar në kriteret dhe kushtet për kualifikim Kapaciteti Teknik, pika 3.

Operatori ekonomik "NIKA" shpk nuk ka paraqitur Vertetim të leshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj: për periudhën **Shkurt 2015- Dhjetor 2015**, kërkesë dhe përcaktuar në kriteret dhe kushtet për kualifikim Kapaciteti Teknik, pika 4/i.

Operatori ekonomik "NIKA" shpk nuk ka të siguruar punonjësit: 1 inxhinier ndërtimi, 2 montator, kërkesë dhe përcaktuar në kriteret dhe kushtet për kualifikim Kapaciteti Teknik, pika 8. Është paraqitur kontratë e punës Nr. 71, Kol 34/1 datë 19.01.2016, e lidhur ndërmjet punëdhënësit shoqëria "NIKA" shpk dhe punëmarrësit Z.Ledio Balliu, në të cilin nuk është përcaktuar profesioni i punëmarrësit. Gjithashtu, shoqëria "NIKA" shpk, nuk ka respektuar detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë (Sigurimet Shoqërore-Punëdhënësi është i detyruar të regjistrojë dhe të paguajë çdo muaj kontributet e punëmarrësit tek sigurimet shoqërore) për regjistrimin dhe pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore pasi nuk rezultoi të deklaruar në listat e shoqërisë për muajin **Janar – shkurt 2016**.

Operatori ekonomik "NIKA" shpk nuk plotëson kërkesat dhe përcaktuar në kriteret dhe kushtet për kualifikim Kapaciteti Teknik, pika 9/d. (*Shoqëria duhet të ketë me qera ose të disponojë skelë të certifikuar sipas Standarteve Europiane me garanci teknike për qëndrueshmëri dhe skelë të punimeve të montimit dhe çmontimit të tyre, konform KTZ (Kushteve Teknike të Zbatimit) sipas manualeve të montimit dhe projektit.*)

Operatori ekonomik duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje në thelb me kërkesat dhe përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat dhe përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor është ofertë e operatorit ekonomik të pavlefshme. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet dhe përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Për sa më sipër, operatori ekonomik “NIKA” shpk nuk ploteson kërkesat e percaktuara ne shtojcen 10, pika 2 Kriteve te Veçanta te Kualifikimit, prandaj skualifikohet.

* * *

1. Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqerine **“VËLLAZËRIA” sh.p.** **NIPT: J76418901** Ise oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej Vlera **14,507,603** (katëmbdhjetëmilin e pesëqind e shtatë mijë e gjashtëqind e tre) **leke pa tvshështë** identifikuar si oferta e suksesëshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkia Hassigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, **brenda 30 (tridhjetë) ditëve (VKM, 914, neni21/4)** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **26.04.2016.**

Ankesa: ka ose jo **Jo,**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

Adem LALA

[Drejtuesi i autoritetit kontraktor]

Open
Procurement
Albania